

**VENDIM**  
**Nr.1042, datë 14.10.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KRUTJE, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Krutje të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Krutje të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.66, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Krutje të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Krutje për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Krutje

Lidhja nr.1

| <b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b>                                            | <b>Lloji i transferimit</b> |
|---------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| 1-18                                                    | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                        | Në pronësi                  |
| 19-20                                                   | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.   | Në pronësi                  |
| 21-26                                                   | Monumente historike, buste me interes vendor&prona social-kulturore e sportive | Në pronësi                  |
| 27-82,279-303,316                                       | Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike          | Në pronësi                  |
| 83-96                                                   | Shërbime funerale                                                              | Në pronësi                  |
| 97-133                                                  | Prona që përdoren për realizimin e mbrojtjes civile.                           | Në pronësi                  |
| 134-151                                                 | Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.                             | Në përdorim                 |
| 164,180,196,200,209,213,220, 234,241,246,250,253        | Prona që përdoren në fushën e kullimit dhe ujitjes.                            | Në pronësi                  |
| 254,256,258,260,262,264,266, 268-271                    | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë bujqësore.          | Në përdorim                 |
| 255,257,259,261,263,265,267                             | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë jobujqësore.        | Në përdorim                 |
| 272-278                                                 | Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm                                         | Në pronësi                  |